

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 197 Prot.

Tiranë, më 17.032015

**VENDIM Nr. 25, datë 11.03.2015**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore” (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, të datës 11.03.2015, pasi shqyrtoi “Relacionin mbi verifikimin në terren, të gjetjeve arkeologjike të zbuluara gjatë punimeve, në kuadër të projektit "Vija bregdetare e qytetit Vlorë"-FSHZH, paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

**VENDOSI:**

- I. Për zonën e paprekur në fshatin Xhyherinë, ku merret materiali që shërben për mbushjen e plazhit, në kuadër të projektit "Vija bregdetare e qytetit Vlorë"-FSHZH, të kryhet nga një subjekt i licensuar gjermim shpëtimi dhe të dokumentohet siti, duke lidhur aktmarrëveshje përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, ndërmjet ASHA, subjektit të licensuar dhe subjektit ndërtues që zbaton projektin e sipërpërmendur. Raporti i tij të paraqitet në KKA e rradhës.
- II. Për ndërhyrjet pa leje, të kryera gjatë marrjes së materialit që shërben për mbushjen e plazhit, në kuadër të projektit "Vija bregdetare e qytetit Vlorë"-FSHZH, në fshatin Xhyherinë, të njoftohen organet përkatëse, për vendosjen e gjobës ndaj subjektit ndërtues që zbaton projektin e sipërpërmendur, i cili është përgjegjës për to.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**